



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritime Evropiane

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 21. 12. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Naser Rugova, Nait Hasani dhe Mursel Halili.

Mungoi: Bujar Bukoshi.

Me ftesë: Rifat Blaku – zëvendësministër dhe Avni Kastrati - drejtor i Entit të Statistikave.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 17. 11. 2009,
3. Takim me ministrin e Administratës Publike, z. Arsim Bajrami,
4. Shqyrtimi i propozimeve për Rregulloren e punës të Kuvendit të Kosovës,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësim dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,

8. Shqyrtimi i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,

9. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 17. 11. 2009.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Takim me ministrin e Administratës Publike, z. Arsim Bajrami.

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se për të raportuar lidhur me statistikave në Kosovë i pranishëm ishte zëvendësministri, Rifat Blaku, si dhe drejtori i Entit të Statistikave të Kosovës, z. Avni Kastrati. Shtoi se ky takim është në vazhden e mbikëqyrjes së punës së Qeverisë sa i përket zbatimit të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian. Njoftoi se pas publikimit të Raportit të Progresit, Komisioni ka mbajtur mbledhje dhe i ka ndarë prioritetet, me të cilat do të punohet gjatë këtij viti. Njëri ndër ta është edhe prioritet i statistikave në Kosovë. Sa u përket statistikave, tha se qysh vitin e kaluar, në një takim, që e kishim në Bruksel, na është bërë vërejtje lidhur me mungesën e statistikave. Tha se pa statistika nuk mund të dimë se cilat janë dobësitë e sistemit ekonomik, që e pengojnë edhe zhvillimin ekonomik.

Rifat Blaku – zëvendësimistër - Njoftoi se pas publikimit të Raportit të Progresit, Zyra për Integritet Evropian në Ministrinë e Administratës Publike, së bashku me Entin e Statistikave, e kanë analizuar Raportin e Progresit dhe së bashku i kanë adresuar këto sfida, të cilat janë shndërruar në veprime konkrete dhe i janë përcjellë Agjencisë për Koordinim dhe Zhvillim të Integriteteve Evropiane. Sa u përket statistikave kemi bashkëpunim të ngushtë me Entin e Statistikave që ta zhvillojmë një sistem bashkëkohor, në mënyrë që edhe Kosova gradualisht të fillojë të bëjë statistika të sakta dhe të besueshme, sepse statistikave paraqesin edhe një standard për funksionim të shtetit. Problem kryesorë e kemi mosregjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave e si pasojë e këtyre i kemi edhe vërejtjet, të cilat kanë ardhur nga Komisioni Evropian. Shtoi se jemi në vllugun e përgatitjeve me faktorin ndërkombëtar dhe e kemi marrë me shumë seriozitet, sepse prodhimi i statistikave zyrtare është një çështje komplekse. Këto janë elementet e përgjithshme, ndërsa për hollësi më gjerësisht do t'ju njoftojë drejtori i Entit të Statistikave z. Avni Kastrati.

Avni Kastrati - Tha se Enti i Statistikave është një institucion shumë i rëndësishëm dhe njëri ndër katër kriteret që duhet ta plotësojë Kosova gjatë aderimit në Bashkësinë Evropiane. Sa i përket besueshmërisë së statistikave tha se pa një regjistrim të mirëfillt të popullsisë nuk do të kemi nivel të duhur të statistikave. Si kriter tjetër, përveç regjistrimit të popullsisë, është edhe regjistrimi i bujqësisë dhe i bizneseve, ndërsa në këto tri makro-data nuk i posedojmë dhe shkaqet i dimë të gjithë. Njoftoi se në mungesë të kapaciteteve dhe të legjislacionit përkatës, nuk mund të bëhen statistika për sektorin ekonomik dhe për atë social. Nuk ka harmonizim në nivel të Kosovës sa i përket bazës së të dhënave. Sa i përket bashkëpunimit me institucionet publike shembull është Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, që nuk na e jep bazën e të dhënave për qarkullimin dhe për të punësuarit në bizneset private, përkundër memorandumit të nënshkruar me këtë institucion për publikime. Andaj nuk mund të publikojmë raporte për të punësuarit në bizneset private dhe për qarkullimin e bizneseve private. Ne kemi sistem tjetër për publikim e hyrje-daljeve. Shtoi se mungesa e legjislacionit na pengon për t'i marrë të dhënat nga bizneset private. Këtë e elaboroi me faktin se nga 3200 biznese private, që kanë në qarkullim më se 50 mijë euro, vetëm dy mijë prej tyre na përgjigjen në formularët që ua dërgojmë. Kjo bëhet për shkak se nuk kemi fuqi administrative për t'i obliguar ata që t'u përgjigjen këtyre formularëve. Nga të dhënat e vitit 2004, nga Enti i Statistikave, ka dalë se rreth 23% e bizneseve janë biznese joformale. Sipas disa raporteve të fundit vlerësohet se 25 deri 30% e bizneseve janë joformale dhe se Enti i Statistikave, kur del me raporte gjatë vitit, nuk janë shumë reprezentative, sepse nuk kemi të dhëna për ato biznese. Çështje tjetër brengosëse janë bizneset e komunitetit serb. Njoftoi se në të gjitha raportet, të cilat janë përgatitur deri më sot, nuk kanë janë përfshirë bizneset e serbëve. Sa u përket të dhënave, të cilat i kanë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale dhe komunat, janë të dhëna të cilat

nuk azhurnohen nga organizmat përgjegjës. Njoftoi se ka mospërputhje ndërmjet të dhënave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe të të dhënave nga anketat, të cilat i bën Enti i Statistikave lidhur me të dhënat për punëkërkesit. Në vitin 2007 kemi bërë një hulumtim me titull "Me të moshuarit në Kosovë mbi 100 vjet", qëllimi i të cilit ishte të shihej niveli i të dhënave administrative. Gjatë këtij hulumtimi kritere kanë qenë dy baza: baza e regjistrimit civil, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe baza nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale për personat që marrin ndihmë mbi moshën 65-vjeçare. Nga këto të dhëna është parë se baza e regjistrimit civil, mbi 100 vjet i kemi pasur 517 persona, ndërsa sipas Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, baza sipas së cilës marrin ndihma sociale mbi 100 vjet, ka qenë 146, ndërsa kur kemi dalë në terren kemi identifikuar që vetëm 73 persona janë gjallë dhe e marrin këtë ndihmë. Njoftoi se Enti i Statistikave e mbulon edhe fushën e lindje-vdekjeve. Shtoi se e bëjmë raportin duke u bazuar në raportet që merren nga institucionet përgjegjëse. Tani e kemi futur edhe një komponent të rëndësishëm, komponentin e çmimeve në ndërtimtari. Njoftoi se ka një publikim çdo tre muajsh, në të cilin jepen të dhëna për bizneset dhe për ekonominë në përgjithësi. Kemi hartuar një strategji, zbatimin e së cilës do të fillojë në vitin 2010. Sistemi i statistikave përfshin gjashtë ministri, ku 73% e publikimeve bëhen nga të dhënat administrative.

Fatmir Rexhepi – Tha se rëndësia e statistikave qëndron në zhvillimin e makroekonomisë dhe duhet të ketë unifikim të të dhënave, në mënyrë që të mos kemi mospërputhje, sepse për ne kjo situatë është shqetësuese. Sa i përket biznesit joformal të gjitha hallkat duhet t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për ndërprerjen e biznesit joformal, sepse edhe kjo formë e biznesit është krim i organizuar, pavarësisht se nga cili drejtim vjen. Sa i përket përmbushjes së standardeve jemi shumë larg dhe duhet shumë angazhim për arritjen e tyre.

Kryesuesja - Pyeti se a do të ishte dashur që Ministria e Administratës Publike ta bashkërendojë punën ndërmjet institucioneve përgjegjëse për statistika.

Rifat Blaku - zëvendësministri – Theksoi se bëhen përpjekje që vërtet problemet, të cilat na takojnë, t'i zgjidhim. Shembull për këtë e kemi Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, që ka një formë tjetër të formularëve, ndërsa ne me Projektligjin për statistikën zyrtare kemi paraparë të rregullohen sipas standardeve evropiane prodhimi, matja dhe kontrolli i statistikave zyrtare për shtetin. Ende jemi larg, sepse kemi mungesë kapacitetesh humane dhe financiare. Sa i përket tregut të punës edhe shtetet e konsoliduara kanë këso problemesh. Po bëjmë përpjekje të përbashkëta që bashkëpunimi ndërministror të mos jetë problem dhe të bëhet shumë më i madh, sidomos në fushën e statistikave. Kërkoj mbështetje për Entin e Statistikave, sepse po ballafaqohen me probleme të shumta.

Njomza Emini - Pyeti se çfarë hapash konkretë ka ndërmarrë Ministria pas publikimit të Raportit të Progresit nga Komisioni Evropian.

Zëvendësministri - Tha se pas publikimit të Raportit të Progresit, Zyra për Integritet Evropian në Ministrinë e Administratës Publike, së bashku me Entin e Statistikave, e kanë analizuar Raportin e Progresit dhe së bashku i kanë adresuar këto sfida, të cilat janë shndërruar në veprime konkrete dhe i janë përcjellë Agjencisë për Koordinim dhe Zhvillim të Integritet Evropian.

Avni Kastrati - Tha se në disa publikime, të cilat i bëjmë kemi interferime nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga Banka Botërore. Të dy palët na i japin standardet e tyre. E njëjta situatë është edhe me EUROSTAT-in. Njoftoi se vitin e kaluar janë publikuar dy module, njëri sipas standardeve të EUROSTAT-it dhe tjetri sipas standardeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Këtë e potencoi për shkak se shumë dokumente strategjike, që EUROSTAT-i ua dërgon vendeve kandidatë në gjuhën e tyre, neve nuk na i dërgon. Andaj ne duhet ta përkthejmë materialin në gjuhën tonë. Kjo na krijon shpenzime shtesë. Shtoi se kemi mungesë të madhe të buxhetit dhe të stafit profesional në disa fusha të caktuara. Problem tjetër po na paraqet edhe mungesa e sistemit të adresave, sepse kjo ndikon në rritjen e shpenzimeve dhe në prolongimin e të dhënave.

Dzezair Murati - Tha se regjistrimi i popullsisë është një problem shumë i madh, i cili i ka përcjellë të gjitha shoqëritë postkonfliktit. Të gjithë pajtohemi se regjistrimi duhet të bëhet, përveç një grupi të vogël, i cili kërkon që kjo çështje të mos bëhet tani. Pyeti a është koha e mjaftueshme për regjistrimin e popullsisë në prill të vitit 2011, a do të kemi mundësi ta bëjmë regjistrimin e atyre që janë zhvendosur, çka do të bëjmë me pasuritë e tyre dhe çka do të ndodhë me Veriun e Kosovës. Sa më përket mua, viti 2011 është shumë i përshtatshëm për regjistrimin e popullsisë.

Edita Tahiri - Tha se është për keqardhje që për tridhjetë vjet nuk kemi pasur regjistrim as të popullsisë, as të bizneseve, për arsye njohura. Propozoi që debati të orientohet për zgjedhjen e rrugës për rritjen e kapaciteteve humane dhe financiare të Entit Statistikor. Shtoi se Kosova nuk duhet të mbetet çdoherë anonime, andaj çdo vit duhet të dalim me një letërnjoftim të vendit. Statistikat, përveç pengesave në aspektin ekonomik, kanë ndikim edhe në shkencë, për shkak se një numër i madh i studiuesve po heqin dorë nga studimi për Kosovën, për shkak të mungesës së statistikave. Kërkoj që si Komision t'ia japim përkrahjen e duhur këtij institucioni.

Kryesuesja – I falënderoi përfaqësuesit për njoftimin shumë të thukët që e bënë lidhur me statistikën dhe shtoi se për ne u hap një horizont për problemet me të cilat po ballafaqohet Enti i Statistikave. Në emër të Komisionit shprehu gatishmëri për vazhdimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Pas diskutimit të pjesëmarrësve, kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të vazhdohen bashkëpunimi dhe përkrahja e Entit për Statistika nga Komisioni për Integritet Evropian.

4. Shqyrtimi i propozimeve për Rregulloren e punës të Kuvendit të Kosovës

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se eksperti, i cili është në përkrahje të Komisionit, i ka përgatitur amendamentet për Rregulloren e punës të Kuvendit të Kosovës lidhur me Komisionin për Integritet Evropian. Pasi Komisioni për Integritet është i ri nuk ka qenë i përfshirë në Rregullore të punës, andaj për lehtësim të punës, eksperti i ka përgatitur këto propozimamendamente.

Fatmir Rexhepi - Kërkoj që veprimtaria, të cilën e mbulon Komisioni për Integritet Evropian, të mos interferohet me komisionet e tjera dhe të mos ketë mandate të dyfishta.

Naser Rugova - U pajtua me propozimet e deputetit Rexhepi dhe shtoi se qartësimi i punës së Komisionit nuk është rregulluar, sepse nuk përcaktohen financimi adekuat dhe specifikat e Komisionit. Të kërkohet nga Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht nga Kryesia e Kuvendit, që ky Komision të ketë përkrahje më të madhe. Tha se nuk mjafton që vetëm një deklaratë e Agjencisë për Koordinim dhe Zhvillim t'i sjellë tri fjali se nuk i cenon parimet e BE-s. Propozoi që në Rregullore do të duhej të kërkohet që asnjë projektligj të mos kalojë pa e marrë mendimin profesional të Komisionit për Integritet Evropian dhe të Zyrës për Standardizim dhe Harmonizim të Kuvendit. Në parim i përkrahu këto amendamente.

Dzezair Murati - Njoftoi se si anëtar i Komisionit për Rregullore dhe Imunitet ka ngritur shqetësimin pse në Kryesinë e Kuvendit nuk ka përfaqësim të gjinisë femërore. Shtoi se amendamenti tjetër parashihte që partia më e madhe në pushtet t'i kishte dy përfaqësues në Kryesi. Sa u përket mandateve të dyfishta tha se në modelet, të cilat i kishim, nuk lejohej që asnjë deputet të kishte mandate të dyfishta. Specifikë jona është që në dy pushtetet të jetë e njëjta strukturë. A thua të gjithë ministrat janë deputetë? Kjo është absurde.

Fatmir Rexhepi - Tha se çështja së Qeverisë, është çështje e Kushtetutës, andaj kjo nuk na takon neve si Komision të diskutojmë për të.

Nait Hasani - Njoftoi se është një rregull në Kushtetutë, sipas së cilës lejohet që edhe ky mandat të shkojë me këtë formë, ndërsa legjislatura e ardhshme është e rregulluar me Kushtetutë. Sa i përket përfaqësimit të femrave në Kryesinë e Kuvendit është çështje e grupeve parlamentare se kë e konsiderojnë më të denjë për përfaqësimin dhe për mbrojtjen e interesave të tyre në këtë organ.

Kaloyan Simeonovo - ekspert - Tha se këto propozime janë vetëm për Komisionin për Integritet Evropian. Amendamentet janë dy llojesh, njëri për të krijuar një nen të ri për Komisionin dhe tjetri për raportim gjashtëmuor, ndërsa amendamenti i dytë është për ta rregulluar më shumë planin e punës.

Pas diskutimeve kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohen në parim propozimamendamentet e ekspertit së bashku me propozimet e deputetëve.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësim dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja - referuese e këtij projektligji - Shtoi se në mbështetje të Divizionit për Standardizim është shqyrtuar ky projektligj. Konsideroi se mund të procedohet më tutje dhe duhet të përkrahet edhe nga komisionet e tjera, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputeten Njomza Emini ta paraqiste raportin për përputhshmërinë e Projektligjit dhe të amendamenteve të Projektligjit me parimet themelore të *Acquis communautaire*.

Njomza Emini - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim i kemi shqyrtuar këtë projektligj, me amendamente dhe konsiderojmë se mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputeten Edita Tahiri ta paraqesë raportin për përputhshmërinë e Projektligjit dhe të amendamenteve të Projektligjit me parimet themelore të *Acquis communautaire*.

Edita Tahiri - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligji me amendamente, andaj konsiderojmë se mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës , me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja - referuese e këtij projektligji - Shtoi se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kishin shqyrtuar këtë projektligj dhe konsideroi se mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50 min.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisioneve

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi